

SESION INFORMUES


Skema e granteve LOT 1 & LOT 2



Ky aktivitet implementohet nga **D&D Business Support Center**, ndërsa financohet nga GIZ, në emër të Qeverisë Gjermane dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës

Informacion i përgjithshëm mbi Skemën e Granteve për Investime

- Ky projekt synon të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe diversifikimin e aktiviteteve në zonat rurale të Kosovës, me theks të veçantë në **zonat malore** dhe ato **kufitare**.
- Qëllimet kryesore përfshijnë **krijimin e vendeve të reja të punës**, rritjen e të ardhurave, zhvillimin e ekonomisë lokale dhe promovimin e barazisë gjinore.
- Sipas kësaj skeme grantesh, ekzistojnë **2 mundësi mbështetjeje** për përfituesit potencial:
 - **LOT 1** (me mbështetje prej **1,500€** deri në **5,000€**)
 - **LOT 2** (me mbështetje prej **5,001€** deri në **50,000€**)



LOT 1

Informatat më të rëndësishme

Financimi	100% në pajisjet e lejuara.
Forma e mbështetjes	Pajisjet dhe makineritë e kërkuara nga aplikanti do të blihen dhe dorëzohen nga autoriteti kontraktues.
Vlera e mbështetjes	1,500€ deri në 5,000€.
Kohëzgjatja	6 muaj.
Nënsëktorët	– Përpunimi i produkteve bujqësore në fermë dhe jashtë fermës; – Agroturizmi; – Prodhimi i mjaltit; – Produkte pyjore jo-drusore (PPJD) dhe bimë mjekësore dhe aromatike (BMA) të kultivuara, kërpudha, dhe bimë zbukuruese; – Akuakultura; – Rritja e shpendëve për prodhimin e vezëve/mishit; – Aktivitete jobujqësore, p.sh. përpunimi i lëkurës, metalit, drurit, leshit, shërbimet e riparimit të makinerive bujqësore.
Kriteret e përgjithshme:	– Individët duhet të jenë mbi 18 vjeç dhe jo më të vjetër se 65 vjeç në ditën e aplikimit. Ky kriter nuk zbatohet për persona juridik – Individët duhet të jenë të regjistruar në ARBK ose në Regjistrin e Fermerëve, jo më vonë se kur dorëzohen pajisjet – Nëse aplikanti është fermer i regjistruar dhe ka një NIF, nuk ka nevojë të regjistrohet në ARBK.

Aplikantët e pranueshëm

Aplikimi në kuadër të LOT 1 është i hapur për këto kategori:

1. **Individët (personat fizikë)** - që janë banorë të përhershëm të një zone rurale. Por, në rast se përzgjidhen si përfitues, ata duhet të regjistrohen në ARBK, duke specifikuar aktivitetin për të cilin kanë aplikuar, ose në Regjistrin e Fermerëve. Regjistrimi duhet të kryhet para pranimit të pajisjeve.
2. **Fermerët e regjistruar dhe anëtarët e ekonomive familjare bujqësore** - që posedojnë certifikatën e NIF-it.
3. **NMV-të** - duhet të jenë të regjistruara në ARBK dhe të kenë të deklaruar aktivitetin përkatës për të cilin aplikojnë.

Vërejtje: Për qëllimet e këtij programi, termi “ekonomi familjare” nënkupton të gjithë anëtarët që përdorin të njëjtat asete bujqësore, si toka, makineritë, hapësirat e magazinimit, bagëtitë, hambarët dhe objektet ndihmëse. Një ekonomi familjare mund të ketë vetëm një NIF.

Dokumentet që duhet të dorëzohen në momentin e aplikimit

Për të gjithë aplikantët e pranueshëm:

1. **Formulari i aplikimit (Shtojca 1)**
2. **Dokumentet mbështetëse (Shtojca 2)** – shih tabelën vijuese

#	Të përgjithshme
1	Dëshmi nga gjykata që vërteton se aplikanti nuk është dënuar për mashtrim, korrupsion apo përfshirje në ndonjë organizatë kriminale.
	Të dëshmojnë se kanë të drejtën e shfrytëzimit të hapësirës ku do të realizohet investimi:
	• Në rast pronësie – certifikata e pronësisë dhe kopja e planit të vendndodhjes.
2	• Në rast prone familjare - certifikata e pronësisë, kopja e planit të vendndodhjes, dhe deklarata se të gjithë trashëgimtarët pajtohen me përdorimin. • Në rast bashkëpronësie - certifikata e pronësisë, kopja e planit të vendndodhjes, dhe deklarata se bashkëpronarët pajtohen me përdorimin. • Në rast qiraje – një kontratë qiraje e noterizuar, me afat jo më të shkurtër se 3 vjet, që nis nga viti i aplikimit.
3	Vërtetim nga komuna që detyrimet për tatim mbi pronën janë shlyer ose janë rregulluar
#	Për fermerët e regjistruar
1	Kopje e certifikatës së regjistrimit të fermës nga sistemi i Regjistrimit të Fermave në Kosovë.
#	Për ndërmarrjet mikro dhe të vogla
1	Kopje e certifikatës së regjistrimit të biznesit nga ARBK
2	Vërtetimi nga ATK që detyrimet tatimore, përfshirë tatimet mbi të ardhura dhe taksat e tjera përkatëse, janë shlyer ose rregulluar.
3	Certifikata nga ATK për kontributet pensionale të deklaruara dhe të paguara për punëtorët, që vërteton pagesën e kontributeve për 6 muajt e fundit.

3. **Deklaratat (Shtojca 3)** – Dokument që duhet të nënshkruhet nëse aplikanti pajtohet me të gjitha kushtet e ngritura.

Dokumentet që duhet të dorëzohen jo më vonë se data e pranimit të pajisjeve

#	(Nën-sektori 701) Produkte pyjore jo-drusore dhe bimët mjekësore dhe aromatike, kërpudha, bimë zbukuruese
1	Licenca për mbledhjen e PPJD (përfshirë BMA-të e egra), të lëshuar nga Departamenti i Pylltarisë në kuadër të MBPZHR-së. Në mungesë të licencës, duhet të dorëzohet dëshmi se është nisur procedura për pajisje me licencë.
#	(Nën-sektori 702) Agroturizmi
1	Dokument verifikues për regjistrimin në ARBK dhe (nëse aplikohet) të miratuara nga AUV. Në mungesë të regjistrimit, duhet të paraqesë dëshmi se procedura e regjistrimit është iniciuar.
#	(Nën-sektori 703) Përpunimi i produkteve bujqësore në fermë dhe në ekonomi familjare
1	Dokument verifikues për regjistrimin në ARBK dhe (nëse aplikohet) të miratuara nga AUV. Në mungesë të regjistrimit, duhet të paraqesë dëshmi se procedura e regjistrimit është iniciuar.
2	Licenca për prodhimin e verës nga Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari Në mungesë të licencës, duhet të dorëzohet dëshmi se është nisur procedura për pajisje me licencë.
#	(Nën-sektori 704) Prodhimi i mjaltit
1	Dokument verifikues për regjistrimin në ARBK dhe (nëse aplikohet) të miratuara nga AUV. Në mungesë të regjistrimit, duhet të paraqesë dëshmi se procedura e regjistrimit është iniciuar.
#	(Nën-sektori 706) Rritja e shpezëve për prodhimin e vezëve dhe mishit
1	Dokument verifikues për regjistrimin në ARBK dhe (nëse aplikohet) të miratuara nga AUV. Në mungesë të regjistrimit, duhet të paraqesë dëshmi se procedura e regjistrimit është iniciuar.
#	(Nën-sektori 707) Akuakultura
1	Dokument verifikues për regjistrimin në ARBK dhe (nëse aplikohet) të miratuara nga AUV. Në mungesë të regjistrimit, duhet të paraqesë dëshmi se procedura e regjistrimit është iniciuar.
2	Licencë për kultivimin e peshkut nga MMPH. Në mungesë të licencës, duhet të dorëzohet dëshmi se është nisur procedura për pajisje me licencë.
3	Licencë për aktivitete kultivimi të peshkut nga MBPZHR. Në mungesë të licencës, duhet të dorëzohet dëshmi se është nisur procedura për licencim.

Investimet e pranueshme dhe të papranueshme

Investimet e pranueshme	Investimet e papranueshme
– Pajisje dhe makineri të reja, përfshirë edhe pajisje/programe kompjuterike që lidhen drejtpërdrejt me projektin e miratuar. – Makineri për paketim dhe etiketim, që përdoren për prezantimin dhe përgatitjen e produkteve për treg. – Investime për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme, veçanërisht përmes sistemeve diellore fotovoltaike në shkallë të vogël që funksionojnë pa lidhje me rrjetin elektrik, përfshirë panelet, invertorët, bateritë dhe pajisjet e nevojshme për instalim. Gjithashtu, mund të mbështeten edhe sisteme diellore për ngrohjen e ujit. – Investime në menaxhimin e mbeturinave, në përputhje me natyrën e aktivitetit dhe objektivat e projektit, si për shembull pajisje për riciklim ose kompostim.	– Blerja e tokës ose e ndërtesave ekzistuese. – Blerja e pajisjeve apo makinerive të përdorura. – Blerja e të drejtave për prodhimin bujqësor. – Blerja e bimëve njëvjeçare dhe mbjellja e tyre. – Shpenzimet e bëra nga aplikanti. – Shpenzimet operative të fermës apo biznesit. – Shpenzimet që nuk kanë lidhje me projektin e investimit. – Normat e interesit, tatimet, detyrimet doganore, kostot për licenca. – Kontribut jo-monetar (puna apo materialet e siguruara nga vetë aplikanti). – Investimet e realizuara para nënshkrimit të kontratës.




Kriteret specifike të pranueshmërisë dhe investimet e pranueshme sipas nënsektorëve

Nënsektori	Produkte pyjore jo-drusore (PPJD) dhe bimë mjekësore dhe aromatike (BMA) të kultivuara, kërpudha, dhe bimë zbukuruese
Përshkrimi	Mbështetja synon përmirësimin e praktikave të mbledhjes, grumbullimit, ruajtjes dhe distribuimit të PPJD-ve (përfshirë BMA-të e egra). Gjithashtu, synohet rritja e cilësisë së BMA-ve të kultivuara, kërpudhave dhe bimëve zbukuruese. Përparësi u jepet projekteve që zbatojnë parimet e prodhimit organik.
Kriteret specifike të pranueshmërisë	– Aplikantët duhet të posedojnë licencë të vlefshme për mbledhjen e PPJD, të lëshuar nga Departamenti i Pylltarisë (MBPZHR); – Në rast se aplikimi ka të bëjë me produkte organike, aplikantët duhet të posedojnë certifikatë për prodhim organik.
Investimet specifike të pranueshmërisë	– Pajisje për kultivimin dhe vjeljen ose mbledhjen e BMA-ve të kultivuara, kërpudhave dhe bimëve zbukuruese; – Pajisje për mbledhjen e PPJD-ve; – Kontejnerë për transportimin e produkteve deri te pikat e grumbullimit; – Pajisje për peshimin, prerjen, bluarjen, copëtimin, klasifikimin, ndarjen dhe tharjen e produkteve të vjelura ose të mbledhura; – Pajisje për pasterizim dhe sterilizim të produkteve; – Pajisje për ruajtjen e produkteve; – Pajisje për monitorimin e cilësisë, si dhe sisteme për kontroll gjatë pranimit/ruajtjes/përpunimit/paketimit/shpërndarjes; – Pajisje për analiza (me përjashtim të enëve prej qelqi dhe veglave të vogla laboratorike); – Pajisje kompjuterike dhe softuerë përkatës, përfshirë sensorë (vetëm ato që lidhen drejtpërdrejt me pajisjet e pranueshme).

Kriteret specifike të pranueshmërisë dhe investimet e pranueshme sipas nënsektorëve

Nënsektori	Agroturizmi
Përshkrimi	Mbështetja synon të nxisë diversifikimin e aktiviteteve bujqësore në fermë përmes kombinimit me shërbime turistike si akomodimi, ushqimi dhe pijet, dhe aktivitete rekreative. Përparësi do t'u jepet projekteve që planifikojnë të ofrojnë këto shërbime duke përdorur produkte bujqësore nga prodhimi i tyre ose nga fermerë lokalë, për përgatitjen e ushqimeve për vizitorët dhe/ose për t'u shitur vizitorëve/turistëve.
Kriteret specifike të pranueshmërisë	Aplikantët duhet të jenë të regjistruar në ARBK dhe (nëse aplikohet) të miratuara nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV).
Investimet specifike të pranueshmërisë	– Pajisje për dhomat e vizitorëve në bujtina; – Pajisje sanitare dhe reception; – Pajisje dhe makineri për kuzhinë profesionale; – Pajisje të tjera ndihmëse për përgatitjen dhe shërbimin e ushqimeve dhe pijeve; – Mobilje për restorantet e vogla, hapësirat e shijimit dhe dyqanet brenda fermës; – Pajisje dhe makineri për organizimin e aktiviteteve rekreative brenda fermës.



Kriteret specifike të pranueshmërisë dhe investimet e pranueshme sipas nënsektorëve

Nënsektori	Përpunimi i produkteve bujqësore në fermë dhe në ekonomitë familjare
Përshkrimi	Mbështetja synon të nxisë prodhimin e produkteve ushqimore tradicionale dhe atyre me vlerë të shtuar, të cilat përpunohen nga lëndë të para bujqësore të siguruara nga zona lokale dhe rajonale brenda Kosovës.
Kriteret specifike të pranueshmërisë	– Aktivitetet e pranueshme përfshijnë përpunimin e produkteve bujqësore primare (mishi, qumështi), frutat, perimet, drithërat, etj. – Lënda e parë duhet të jetë nga prodhimi i vet aplikantit ose të jetë blerë nga fermerë lokalë dhe rajonalë brenda territorit të Kosovës. – Gjithashtu, mbështetet përpunimi i produkteve të brumit, përfshirë produktet e pjekura dhe ëmbëlsira tradicionale; – Aplikantët duhet të jenë të regjistruar në ARBK dhe (nëse aplikohet) të miratuara nga AUV; – Në rastin e përpunimit të rrushit, aplikantët duhet të jenë të licencuar si prodhues të verës.
Investimet specifike të pranueshmërisë	– Pajisje për prodhimin e salsiçeve/suxhukut/proshutës, për trajtimin e mishit të freskët dhe për paketimin me vakum; – Makineri për përpunimin e qumështit në produkte të tilla si djathë, kos, krem, gjalpë dhe produkte të tjera të fermentuara; – Pajisje për përpunimin e frutave në produkte si lëngje, marmelata, reçel, uthull, verë dhe pije alkoolike; – Pajisje për tharjen dhe përpunimin e produkteve të thata, erëzave, produkteve bimore të përgatitura nga fruta, perime dhe BMA-të; – Pajisje për përzierje, përgatitjen e ekstrakteve dhe prodhimin e çajit, duke përfshirë edhe makineri për paketimin e qeseve të çajit; – Pajisje për pastrimin, larjen, klasifikimin dhe paketimin e perimeve, si dhe objektet ndihmëse për ruajtjen e tyre; – Pajisje për prodhimin e bukës, ëmbëlsirave, biskotave dhe tortave; – Pajisje dhe orendi të vogla për shitje të drejtpërdrejtë në ferma ose ekonomi familjare, si rafte, frigoriferë dhe tavolina; – Makineri për përpunimin e drithërave, arrove dhe bishtajoreve në produkte me vlerë të shtuar; – Pajisje për ruajtje e produkteve në temperaturë të ulët, si frigoriferë dhe ngrirës, për të ruajtur cilësinë e produktit; – Sisteme sanitare dhe pajisje për pastrim, për të siguruar higjienën dhe sigurinë ushqimore;


Kriteret specifike të pranueshmërisë dhe investimet e pranueshme sipas nënsektorëve

Nënsektori	Prodhimi i mjaltit
Përshkrimi	Mbështetja synon rritjen e prodhimit dhe përmirësimin e produktivitetit të mjaltit në zonat rurale. Përkrahja u dedikohet si bletarëve fillestarë, ashtu edhe atyre me përvojë që synojnë të zgjerojnë ose të përmirësojnë aktivitetin e tyre në fushën e bletarisë.
Kriteret specifike të pranueshmërisë	- Aplikantët duhet të jenë të regjistruar në ARBK dhe (nëse aplikohet) të miratuara nga AUV.
Investimet specifike të pranueshmërisë	- Koshere bletësh me inventar, duke përfshirë dysHEME kundër varroas; - Pajisje për trajtimin e bletëve, si tymëse, furçë, si dhe pajisje për kontrollin e cilësisë së mjaltit; - Pajisje për nxjerrjen e mjaltit (centrifuga, mjete për hapjen e hojeve të mjaltit); - Shkrirës dylli për hoje; - Pajisje për mbushje dhe ruajtje të mjaltit; - Pajisje për shitje në ferma, ekonomitë familjare dhe tregje; - Pajisje për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve të bletëve; - Pajisje për prodhimin e nënprodukteve të mjaltit, si polen, qumësht mbretëreshë, propolis); - Pajisje për nxjerrjen e qumështit mbretëreshë dhe rritjen e mbretëreshës.

Kriteret specifike të pranueshmërisë dhe investimet e pranueshme sipas nënsektorëve

Nënsektori	Aktivitetet jo-bujqësore
Përshkrimi	Mbështetja synon përmirësimin e artizanatit tradicional në zonat rurale përmes përdorimit të pajisjeve moderne, materialeve lokale dhe ofrimit të shërbimeve që mbështesin bujqësinë dhe popullsinë rurale.
Kriteret specifike të pranueshmërisë	Aktivitetet jo-bujqësore të pranueshme përfshijnë: – Përpunimi dhe prodhimi i lëkurës, leshit, drurit, metalit, letrës/kartonit, gurit, qeramikës/poçarisë dhe tekstilit. – Prodhimi i humusit.
Investimet specifike të pranueshmërisë	– Pajisje teknike për prodhimin/përpunimin e lëkurës, leshit të deleve, drurit, metalit, qelqit, gurit, argjilës, tekstilit dhe letrës/kartonit; – Pajisje teknike për prodhimin e humusit; – Pajisje dhe materiale për pikat e shitjes të produkteve; – Pajisje për ofrimin e shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së makinerive bujqësore; – Pajisje për magazinimin dhe shpërndarjen e produkteve;

Kriteret specifike të pranueshmërisë dhe investimet e pranueshme sipas nënsektorëve


	Nënsektori	Rritja e shpezëve për prodhim të vezëve dhe mishit
Përshkrimi	Mbështetja synon të nxisë zhvillimin e blegtorisë së shpezëve, në shkallë të vogël, për prodhimin e mishit dhe vezëve. Fokusi është në përmirësimin e produktivitetit, sigurimin e sigurisë ushqimore dhe promovimin e standardeve të mirëqenies së kafshëve.	
Kriteret specifike të pranueshmërisë	– Aplikantët duhet të jenë të regjistruar në ARBK dhe (nëse aplikohet) të miratuara nga AUV.	
Investimet specifike të pranueshmërisë	– Rrethoja për mbajtjen e shpezëve në hapësira të lira; – Kutitë për fole dhe shtëpiza të lëvizshme; – Inkubatorë të vegjël që përputhen me kapacitetin e prodhimit; – Enë për ujë të pijshëm për shpezët; – Enë për ushqim shpezëve; – Pajisje për pastrimin, klasifikimin dhe paketimin e vezëve; – Pajisje për largimin, trajtimin dhe ruajtjen e plehut organik.	

Kriteret specifike të pranueshmërisë dhe investimet e pranueshme sipas nënsektorëve

Nënsektori	Akuakultura
Përshkrimi	Mbështetja synon të nxisë kultivimin e peshkut në ujëra të ëmbla, në shkallë të vogël. Përkrahja përfshin pajisje dhe mjete themelore që janë të nevojshme për të siguruar cilësinë, higjienën dhe qëndrueshmërinë e prodhimit të peshkut.
Kriteret specifike të pranueshmërisë	– Aplikantët duhet të jenë të regjistruar në ARBK dhe (nëse aplikohet) të miratuara nga AUV. – Aplikantët duhet të posedojnë licencë të vlefshme për kultivimin e peshkut nga MMPH, në varësi të kapacitetit prodhues. – Aplikantët duhet të posedojnë licencë të vlefshme për aktivitetet e akuakulturës/kultivimin e peshkut nga MBPZHR.
Investimet specifike të pranueshmërisë	– Pajisje për ajrosjen dhe oksigjenimin e ujit, si dhe për monitorimin e parametrave të tij; – Pajisje (pompa) për klasifikimin dhe transportin e peshqve brenda fermës; – Pajisje për ushqyerjen e peshkut; – Pajisje për transportin e peshqve të gjallë; – Pajisje për dezinfektimin, filtrimin dhe pastrimin e ujit; – Pajisje për ruajtjen e peshkut të freskët, makina për prodhimin e akullit, tanka ftohës; – Pajisje për therjen dhe pastrimin e peshkut, si dhe për manipulimin, asgjësimin, ruajtjen dhe trajtimin e mbetjeve; – Pajisje për monitorimin e cilësisë, sisteme për kontrollin të lidhura me kultivimin, ruajtjen dhe shpërndarjen;

Procedura për dorëzimin e aplikimit

1. Thirrja për aplikim	E publikuar në faqen e internetit dhe në mediat sociale të MBPZHR-së, AZHB-së, dhe GIZ.
2. Periudha dhe mënyra e aplikimit	– Thirrja për aplikime do të jetë e hapur për dy (2) muaj, deri më 22 Shtator 2025. – Gjatë kësaj periudhe, formulari i aplikimit së bashku me të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike përmes uebfaqes rural-development-kosovo.grantplatform.com – Si alternativë, aplikantët mund të dorëzojnë 1 kopje fizike (të shtypur) të pakos së plotë të aplikimit të Zyrtari për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në komunën përkatëse. Formularët duhet të jenë të plotësuar në mënyrë elektronike (në kompjuter) dhe jo të shkruar me dorë.



Kriteret e përzgjedhjes

#	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1	Projekti kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike	15
2	Projekti krijon vende të reja pune dhe/ose ruan vendet ekzistuese të punës	15
3	Projekti investon në përputhshmëri me standardet minimale kombëtare (p.sh. Siguria ushqimore, mbrojtja e mjedisit, etj.)	15
4	Projekti promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore (p.sh. Riciklimi, ripërdorimi i ujit, shfrytëzimi me vlerë i mbetjeve, përdorimi i energjisë së ripërtëritshme për konsum vetanak, etj.)	15
5	Projekti zbatohet në një zonë malore	15
6	Aplikanti është fermer ose ndërmarrës i ri (nën 40 vjeç në momentin e aplikimit).	10
7	Aplikanti është grua	10
8	Aplikanti i përket një grupi minoritar	5
	Shuma e përgjithshme e pikëve	100

SHËNIM: Aplikimet që marrin më pak se 50 pikë nuk do të konsiderohen të pranueshme

LOT 2

Informatat më të rëndësishme

Financimi	Maksimumi prej 70% të kostove të pranueshme të investimit të projektit (Ndarja e kostove për një artikull të vetëm, p.sh., 70% nga GIZ dhe 30% nga kompania) nuk lejohet!
Forma e mbështetjes	Pajisjet dhe makineritë e kërkuara nga aplikanti do të blihen dhe dorëzohen nga autoriteti kontraktues.
Vlera e projektit	5,001€ deri në 50,000€.
Kohëzgjatja	12 muaj.
Nënsëktorët	– Përpunimi i produkteve bujqësore në fermë dhe jashtë fermës; – Agroturizmi; – Prodhimi i mjaltit; – Produkte pyjore jo-drusore (PPJD) dhe bimë mjekësore dhe aromatike (BMA) të kultivuara, kërpudha, dhe bimë zbukuruese; – Akuakultura; – Rritja e shpendëve për prodhimin e vezëve/mishit; – Aktivitete jobujqësore, p.sh. përpunimi i lëkurës, metalit, drurit, leshit, shërbimet e riparimit të makinerive bujqësore.
Kriteret e përgjithshme:	– Në rast se aplikanti është fermer i regjistruar me NIF, nuk ka nevojë të regjistrohet në ARBK për qëllimet e kësaj thirrjeje. – Përfituesit që nuk janë të licencuar/regjistruar, duhet të nisin procedurat për licencim/regjistrim jo më vonë se në ditën e pranimit të pajisjeve.

Aplikantët e pranueshëm

Aplikimi në kuadër të LOT 2 është i hapur për këto kategori:

1. **Fermerët e regjistruar dhe anëtarët e ekonomive familjare bujqësore** - që posedojnë certifikatën e NIF-it
2. **NMVM-të** - duhet të jenë të regjistruara në ARBK dhe të kenë të deklaruar aktivitetin përkatës për të cilin aplikojnë.

Vërejtje: Për qëllimet e këtij programi, termi “ekonomi familjare” nënkupton të gjithë anëtarët që përdorin të njëjtat asete bujqësore, si toka, makineritë, hapësirat e magazinimit, bagëtitë, hambarët dhe objektet ndihmëse. Një ekonomi familjare mund të ketë vetëm një NIF.

Dokumentet që duhet të dorëzohen në momentin e aplikimit

Për të gjithë aplikantët e pranueshëm:

1. **Formulari i aplikimit (Shtojca 1)**
2. **Propozimi Teknik (Shtojca 2)**
3. **Buxheti, kthimi i investimit dhe rrjedha e parasë (Shtojca 3)**
4. **Dokumentet mbështetëse (Shtojca 4) – shih tabelën vijuese**

#	Të përgjithshme
1	Dëshmi nga gjykata që aplikanti dhe biznesi nuk janë të dënuar për mashtrim, korrupsion apo përfshirje në një organizatë kriminale.
2	Në rast të pronës personale një kopje e certifikatës së pronësisë dhe një kopje e planit të vendndodhjes; Në rast prone familjare duhet të deklarohet përmes një deklarate me shkrim (të nënshkruar) se të gjithë trashëgimtarët pajtohen me përdorimin; Në rast bashkëpronësie duhet të deklarohet përmes një deklarate me shkrim (të nënshkruar) se të gjithë bashkëpronarët pajtohen me përdorimin; Në rast qiraje një kontratë qiraje e noterizuar, me kohëzgjatje jo më pak se tre (3) vjet, duke filluar nga viti i aplikimit.
3	Vërtetim nga komuna që detyrimet për tatimin mbi pronën janë shlyer ose janë rregulluar. Personat juridikë duhet të dëshmojnë se kanë shlyer ose kanë rregulluar të gjitha detyrimet tatimore, përfshirë tatimin mbi të ardhurat, tatimin në pronë dhe taksat e tjera përkatëse.
4	Dëshmi që vërteton përfundimin e shkollimit fillor. Nëse aplikimi bëhet nga biznesi, ky kriter zbatohet për pronarin ose përfaqësuesin e autorizuar.
5	Bilanci në llogarinë bankare për 6 muajt e fundit, të paktën 25% e qarkullimit të vlerës së bashkëfinancimit nga përfituesi.
6	Në rastin kur planifikohen punime ndërtimi, rinovimi ose zgjerimi, nga bashkëfinancimi, dokumentet që duhen dorëzuar janë: • Arkitekturë konceptuale, duke përfshirë vlerësimet e kostos për materialet dhe punën. • Projekti i përgatitur nga arkitekti. • Kopja e licencës së arkitektit

Dokumentet që duhet të dorëzohen në momentin e aplikimit

#	Për fermerët e regjistruar
1	Kopje e certifikatës NIF.
2	Nëse është person juridik, konfirmim nga ATK-ja se detyrimet tatimore, duke përfshirë tatimin mbi të ardhurat dhe taksat e tjera të zbatueshme, janë shlyer ose rregulluar.
#	Për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme
1	Kopje e certifikatës së biznesit ARBK.
2	Në rastet kur projekti nuk menaxhohet nga pronari, atëherë autorizim për menaxhimin e projektit për përfaqësuesin ligjor (i vërtetuar nga noteri).
3	Certifikatë e kontributeve pensionale të deklaruara dhe të paguara për punonjësit nga ATK-ja që vërteton kontributin e paguar në 6 muajt e fundit.
4	Konfirmim nga ATK se detyrimet tatimore, duke përfshirë tatimin mbi të ardhurat dhe taksat e tjera të zbatueshme, janë shlyer ose rregulluar.
5	Qarkullimi vjetor i entitetit aplikues nga viti i kaluar (i cili duhet të jetë të paktën i barabartë me shumën totale të kostos së investimit të propozuar).
#	Për nën-sektorin “Përpunimi i produkteve bujqësore në fermë dhe në ekonomitë familjare”
1	Në rastet e përpunimit të rrushit me më pak se 3 hektarë vreshta/pemëtore – të dorëzohet kopja e deklarimit vjetor të prodhimit të verës.
2	Në rast të përpunimit të qumështit, deklaratë me shkrim që kapacitetet e përpunimit nuk janë më shumë se 500L qumësht në ditë.
#	Për nën-sektorin “Prodhimi i mjaltit”
1	Dëshmi individuale e certifikuar nga Drejtoria Komunale e Bujqësisë - regjistri i numrit të shoqërive të bletëve dhe vendndodhja e tyre.

Dokumentet që duhet të dorëzohen në momentin e aplikimit

#	Për nën-sektorin “Rritja e shpendëve për vezë dhe prodhim mishi”
1	Duhet vërtetuar të paktën 5 m ² tokë/koka pule ose rose ose 15 m ² tokë/koka gjeldeti ose pate
2	Deklaratë me shkrim për numrin minimal të kafshëve, sipas kritereve të pranueshmërisë.
#	Për nën-sektorin “Akuakultura”
1	Vërtetim i prodhimit të peshkut të freskët në vitin e kaluar, minimum 5-ton në vit. (Kjo vërtetohet nga pagesat direkte për sasinë e peshkut të shitur në vitin e kaluar ose nga dëshmitë nga ATK për sasinë e peshkut të shitur.)

5. Deklaratat (Shtojca 5)

Investimet e pranueshme dhe të papranueshme

Investimet e pranueshme	Përfshirje për investimet e mbuluara nga kontributi vetjak	Investimet e papranueshme
Kategoritë e investimeve që mund të mbështeten përmes grantit:	Në kuadër të kontributit vetjak, pranohen edhe këto lloje investimesh:	Investimet që nuk do të mbështeten nga granti i investimit të ofruar nga autoriteti kontraktues, përfshijnë:
– Pajisje dhe makineri të reja; – Makineri për paketim/etiketim. – Energji të ripërtëritshme; – Menaxhimin e mbeturinave (riciklim, kompostim)	– Punimet ndërtimore; – Ndërtimet e reja; – Zgjerimet dhe rinovimet; – Kostot për materialet ndërtimore; – Kostot për fuqinë punëtore. Këto shpenzime janë të pranueshme vetëm nëse realizohen pas nënshkrimit të kontratës. – Në rastet kur kërkohet leje ndërtimi, përfituesi duhet të sigurojë miratimin nga komuna. – Në rastet kur kërkohet vlerësim i ndikimit në mjedis, ky proces duhet të jetë përfunduar përpara dorëzimit të pajisjeve. – Në rastet e investimit në objekte të përfshira në Listën e Trashëgimisë Kulturore duhet të sigurohet miratimi nga MKRS. – Shërbimet për projektim arkitektonik, të pranueshme deri në 10% të shumës së investimit për ndërtim, zgjerim ose rinovim. – Shpenzimet për marketing të produktit, të pranueshme deri në 10% të kostos totale të investimit.	– Punimet e ndërtimit, zgjerimit apo rinovimit – Materialet ndërtimore dhe punën fizike; – Blerja e tokës ose e ndërtesave ekzistuese; – Blerja e pajisjeve apo makinerive të përdorura; – Blerja e të drejtave për prodhimin bujqësor; – Blerja e bimëve njëvjeçare dhe mbjellja e tyre; – Marrja me qira financiare, përfitimi i qiradhënësit; – Kostot për refinancimin e interesit; – Shpenzimet e përgjithshme; – Tarifat e sigurimit; – Shpenzimet e bëra nga Aplikanti; – Shpenzimet operative të fermës apo biznesit; – Shpenzimet që nuk kanë lidhje me projektin; – Normat e interesit, tatimet, detyrimet doganore; – Kostot për licenca; – Humbjet nga kurset e këmbimit valutor; – Kontribut jo-monetar; – Investimet para nënshkrimit të kontratës.




Kriteret specifike të pranueshmërisë dhe investimet e pranueshme sipas nënsektorëve

Nënsektori	Produkte pyjore jo-drusore dhe bimë mjekësore dhe aromatike të kultivuara, kërpudha, dhe bimë zbukuruese
Përshkrimi	Mbështetja fokusohet në përmirësimin e praktikave të mbledhjes, grumbullimit, ruajtjes dhe distribuimit të PPJD-ve (përfshirë edhe BMA-të e egra). Gjithashtu, synohet rritja e cilësisë së BMA-ve të kultivuara, kërpudhave dhe bimëve zbukuruese. Përparësi u jepet projekteve që zbatojnë parimet e prodhimit organik.
Kriteret specifike të pranueshmërisë	– Aplikantët duhet të posedojnë licencë të vlefshme për mbledhjen e PPJD, lëshuar nga Departamenti i Pylltarisë (MPBZHR); – Në rast se aplikimi ka të bëjë me produkte organike, aplikantët duhet të posedojnë certifikatë të vlefshme për prodhim organik.
Investimet specifike të pranueshmërisë	– Pajisje për kultivimin dhe vjeljen ose mbledhjen e BMA-ve të kultivuara, kërpudhave të kultivuara dhe bimëve zbukuruese; – Pajisje për mbledhjen e produkteve pyjore jo-drusore – Shporta për bartjen e produkteve të vjelura ose mbledhura; – Kontejnerë për transportimin e produkteve deri te pikat e grumbullimit; – Pajisje për peshimin, prerjen, bluarjen, copëtimin, klasifikimin, ndarjen dhe tharjen e produkteve të vjelura ose mbledhura; – Pajisje për pasterizim dhe sterilizim të produkteve; – Pajisje për ruajtjen e produkteve; – Pajisje për monitorimin e cilësisë (me përjashtim të enëve prej qelqi dhe veglave të vogla laboratorike);

Kriteret specifike të pranueshmërisë dhe investimet e pranueshme sipas nënsektorëve

Nënsektori	Agroturizmi
Përshkrimi	Mbështetja synon të nxisë diversifikimin e aktiviteteve bujqësore në fermë përmes kombinimit me shërbime turistike si akomodimi, ushqimi dhe pijet dhe aktivitete rekreative. Përparësi do t'u jepet projekteve që planifikojnë të ofrojnë këto shërbime duke përdorur produkte bujqësore nga prodhimi i tyre ose nga fermerë lokalë, për përgatitjen e ushqimeve për vizitorët dhe/ose për t'u shitur vizitorëve/ turistëve.
Kriteret specifike të pranueshmërisë	– Aplikantët duhet të jenë të regjistruar në ARBK dhe (nëse aplikohet) të miratuara nga AUV.
Investimet specifike të pranueshmërisë	– Pajisje për dhomat e mysafirëve në bujtina, pajisje sanitare dhe reception; – Pajisje dhe makineri për kuzhinë profesionale, si dhe pajisje të tjera ndihmëse; – Mobilje për restorantet e vogla, hapësirat e degustimit (shijimit) dhe dyqanet brenda fermës; – Pajisje dhe makineri për organizimin e aktiviteteve rekreative brenda fermës; – Teknologji të informacionit dhe komunikimit (TIK), si dhe teknologji të tjera digjitale që përdoren në sektorin e mikpritjes.



Kriteret specifike të pranueshmërisë dhe investimet e pranueshme sipas nënsektorëve

Nënsektori	Përpunimi i produkteve bujqësore në fermë dhe në ekonomitë familjare
Përshkrimi	Mbështetja synon të nxisë prodhimin e produkteve ushqimore tradicionale dhe atyre me vlerë të shtuar, të cilat përpunohen nga lëndë të para bujqësore të siguruar nga zona lokale dhe rajonale brenda Kosovës.
Kriteret specifike të pranueshmërisë	– Aktivitetet e pranueshme përfshijnë përpunimin e produkteve bujqësore primare; – Lënda e parë duhet të jetë nga prodhimi i vet aplikantit ose të jetë blerë nga fermerë lokalë dhe rajonalë brenda Kosovës. – Lënda e parë e blerë nga fermerët lokalë ose rajonalë duhet të vërtetohet përmes kontratave ose dokumentacionit; – Aplikantët duhet të jenë të regjistruar në ARBK dhe (nëse aplikohet) të miratuara nga AUV; – Në rastin e përpunimit të rrushit, aplikantët duhet të jenë të jenë të licencuar për prodhim të verës.
Investimet specifike të pranueshmërisë	– Pajisje për prodhimin e salsiçeve/ suxhukut dhe proshutës, për trajtimin e mishit të freskët dhe për paketimin me vakum; – Makineri për përpunimin e qumështit në produkte të tilla si djathë, kos, krem, gjalpë dhe produkte të tjera të fermentuara; – Pajisje për përpunimin e frutave në produkte si lëngje, marmelata, reçel, uthull, verë dhe pije alkoolike; – Pajisje për tharjen dhe përpunimin e produkteve të thata, erëzave, produkteve bimore; – Pajisje për përzierje, përgatitjen e ekstrakteve dhe prodhimin e çajit, duke përfshirë edhe makineri për paketimin e çajit; – Pajisje për pastrimin, larjen, klasifikimin dhe paketimin e perimeve, si dhe objektet ndihmëse për ruajtjen e tyre; – Pajisje për prodhimin e bukës, ëmbëlsirave, biskotave dhe tortave; – Pajisje dhe orëndi të vogla për shitje të drejtpërdrejtë në ferma ose ekonomi familjare, si rafte, frigoriferë dhe tavolina; – Makineri për përpunimin e drithërave, arrove dhe bishtajoreve në produkte me vlerë të shtuar; – Pajisje për ruajtje e produkteve në temperaturë të ulët, si frigoriferë dhe ngrirës, për të ruajtur cilësinë e produktit; – Sisteme sanitare dhe pajisje për pastrim, për të siguruar higjienën dhe sigurinë ushqimore.

Kriteret specifike të pranueshmërisë dhe investimet e pranueshme sipas nënsektorëve

Nënsektori	Prodhimi i mjaltit
Përshkrimi	Mbështetja synon rritjen e prodhimit dhe përmirësimin e produktivitetit të mjaltit në zonat rurale. Përkrahja u dedikohet si bletarëve që synojnë të zgjerojnë ose të përmirësojnë aktivitetin e tyre në fushën e bletarisë.
Kriteret specifike të pranueshmërisë	– Aplikantët duhet të kenë së paku 50 koshere bletësh në momentin e aplikimit. – Aplikantët duhet të jenë të regjistruar në ARBK dhe (nëse aplikohet) ose të miratuara nga AUV.
Investimet specifike të pranueshmërisë	– Koshere bletësh me inventar, duke përfshirë dysheme kundër varroas; – Pajisje për trajtimin e bletëve, si tymëse, furçë, si dhe pajisje për kontrollin e cilësisë së mjaltit; – Pajisje për nxjerrjen e mjaltit (centrifuga, mjete për hapjen e hojeve të mjaltit). – Shkrirës dylli për hoje; – Pajisje për mbushje dhe ruajtje të mjaltit; – Pajisje për shitje në ferma, ekonomitë familjare dhe tregje; – Pajisje për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve të bletëve; – Pajisje për prodhimin e nënprodukteve të mjaltit, si polen, qumësht mbretëreshë, propolis); – Pajisje për nxjerrjen e qumështit mbretëreshë dhe rritjen e mbretëreshës.

Kriteret specifike të pranueshmërisë dhe investimet e pranueshme sipas nënsektorëve

Nënsektori	Aktivitetet jobujqësore
Përshkrimi	Mbështetja synon përmirësimin e artizanatit tradicional në zonat rurale përmes përdorimit të pajisjeve moderne, materialeve lokale dhe ofrimit të shërbimeve që mbështesin bujqësinë dhe popullsinë rurale.
Kriteret specifike të pranueshmërisë	– Përpunimi dhe prodhimi i lëkurës, leshit, drurit, metalit, letrës/kartonit, gurit, qeramikës/poçarisë dhe tekstilit. – Prodhimi i humusit. – Produkte dhe shërbime që lidhen me nënsektorët e pranueshëm në këtë thirrje.
Investimet specifike të pranueshmërisë	– Pajisje prodhim përpunim të lëkurës, leshit të deleve, drurit, metalit, qelqit, gurit, argjilës, tekstilit dhe të letrës/kartonit; – Pajisje teknike për prodhimin e humusit; – Pajisje dhe materiale për pikat e shitjes të produkteve; – Pajisje për ofrimin e shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së makinerive bujqësore; – Pajisje për magazinimin dhe shpërndarjen e produkteve.



Kriteret specifike të pranueshmërisë dhe investimet e pranueshme sipas nënsektorëve


Nënsektori	Rritja e shpezëve për prodhim të vezëve dhe mishit
Përshkrimi	Mbështetja synon të nxisë zhvillimin e blegtorisë së shpezëve, në shkallë të vogël, për prodhimin e mishit dhe vezëve, si një sektor me potencial në rritje në tregun vendas. Fokusi është në përmirësimin e produktivitetit, sigurimin e sigurisë ushqimore dhe promovimin e standardeve të mirëqenies së kafshëve.
Kriteret specifike të pranueshmërisë	Numri minimal i kafshëve në aplikim Pula vojse (pula për vezë): 300 Brojler (pula për mish): 500 Rosa: 300 Pata: 100 Gjeldeti: 100 – Në rastin e mbajtjes së kombinuar, 1 patë ose 1 gjeldet = 3 pula ose 3 rosa. – Sipërfaqja minimale e kërkuar është: 5 m² për çdo pulë ose rosë, dhe 15 m² për çdo patë ose gjeldeti. – Aplikantët duhet të jenë të regjistruar në ARBK dhe (nëse aplikohet) të miratuara nga AUV.
Investimet specifike të pranueshmërisë	– Rrethoja për mbajtjen e shpezëve në hapësira të lira; – Kuti për fole dhe shtëpiza të lëvizshme; – Inkubatorë të vegjël që përputhen me kapacitetin e prodhimit; – Enë për ujë të pijshëm për shpezët; – Enë për ushqim shpezëve; – Pajisje për pastrimin, klasifikimin dhe paketimin e vezëve; – Pajisje për largimin, trajtimin dhe ruajtjen e plehut organik.

Kriteret specifike të pranueshmërisë dhe investimet e pranueshme sipas nënsektorëve

Nënsektori	Akuakultura
Përshkrimi	Mbështetja synon të nxisë kultivimin e peshkut në ujëra të ëmbla, në shkallë të vogël. Përkrahja përfshin pajisje dhe mjete themelore që janë të nevojshme për të siguruar cilësinë, higjienën dhe qëndrueshmërinë e prodhimit të peshkut.
Kriteret specifike të pranueshmërisë	– Aplikantët duhet të kenë një prodhim vjetor të peshkut të freskët prej së paku 5 ton në momentin e aplikimit. – Aplikantët duhet të jenë të regjistruar në ARBK dhe (nëse aplikohet) të miratuara nga AUV. – Aplikantët duhet të posedojnë licencë të vlefshme për kultivimin e peshkut nga MMPH. – Aplikantët duhet të posedojnë licencë të vlefshme për aktivitetet e akuakulturës/kultivimin e peshkut nga MBPZHR.
Investimet specifike të pranueshmërisë	– Pajisje për ajrosjen dhe oksigjenimin e ujit, si dhe për monitorimin e parametrave të tij; – Pajisje për mbarështimin dhe inkubimin e peshqve; – Pajisje (pompa) për klasifikimin dhe transportin e peshqve brenda fermës; – Pajisje për ushqyerjen e peshkut; – Pajisje për transportin e peshqve të gjallë; – Pajisje për dezinfektimin, filtrimin dhe pastrimin e ujit; – Pajisje për ruajtjen e peshkut të freskët; – Pajisje për therjen dhe pastrimin e peshkut, si dhe për manipulimin, asgjësimin, ruajtjen dhe trajtimin e mbetjeve; – Pajisje për monitorimin e cilësisë, si dhe sisteme për kontrollin të lidhura me kultivimin, ruajtjen dhe shpërndarjen.

Procedura për dorëzimin e aplikimit

1. Thirrja për aplikim	E publikuar në faqen e internetit dhe në mediat sociale të MBPZHR-së, AZHB-së, dhe GIZ.
2. Periudha dhe mënyra e aplikimit	– Thirrja për aplikime do të jetë e hapur për dy (2) muaj. – Gjatë kësaj periudhe, formulari i aplikimit së bashku me të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike përmes uebfaqës rural-development-kosovo.grantplatform.com – Si alternativë, aplikantët mund të dorëzojnë një kopje fizike (të shtypur) të pakos së plotë të aplikimit te Zyrtari për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në komunën përkatëse. Formularët duhet të jenë të plotësuar në mënyrë elektronike (në kompjuter) dhe jo të shkruar me dorë.



Kriteret e përzgjedhjes - Produktet pyjore jo-drusore (PJP) duke përfshirë bimët mjekuese dhe aromatike (BMA), kërpudhat dhe bimët zbukuruese

#	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1	Projekti kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike	15
2	Projekti krijon vende të reja pune dhe/ose ruan vendet ekzistuese të punës	15
3	Projekti promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore (p.sh. riciklimi, ripërdorimi i ujit, shfrytëzimi me vlerë i mbetjeve, përdorimi i energjisë së ripërtëritshme për konsum vetanak, etj.)	15
4	Investimet synojnë produkte të reja dhe cilësi të përmirësuar	15
5	Projekti zbatohet në një zonë malore	10
6	Projekti forcon bashkëpunimin me banorët lokalë, përfshirë grumbulluesit, fermerët dhe bizneset e tjera, me qëllim nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik të zonave rurale.	10
7	Projekti nxit prodhimin organik të BMA-ve të kultivuara, kërpudhave dhe bimëve zbukuruese.	7
8	Aplikanti është fermer ose ndërmarrës i ri (nën 40 vjeç në momentin e aplikimit).	5
9	Aplikanti është grua	5
10	Aplikanti i përket një grupi minoritar	3
		100

SHËNIM: Aplikimet që marrin më pak se 50 pikë nuk do të konsiderohen të pranueshme

Kriteret e përzgjedhjes - Agroturizmi

#	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1	Projekti kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike	15
2	Projekti krijon vende të reja pune dhe/ose ruan vendet ekzistuese të punës	15
3	Projekti promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore (p.sh. riciklimi, ripërdorimi i ujit, shfrytëzimi me vlerë i mbetjeve, përdorimi i energjisë së ripërtëritshme për konsum vetanak, etj.)	15
4	Projekti synon të krijojë shërbime të reja dhe të përmirësojë cilësinë në fushën e agroturizmit.	15
5	Projekti zbatohet në një zonë malore	10
6	Projekti forcon bashkëpunimin me fermerë, biznese dhe aktorë lokalë për të nxitur zhvillimin socio-ekonomik të zonave rurale.	10
7	Investime në aktivitete ose produkte të trashëgimisë kulturore	7
8	Aplikanti është fermer ose ndërmarrës i ri (nën 40 vjeç në momentin e aplikimit).	5
9	Aplikanti është grua	5
10	Aplikanti i përket një grupi minoritar	3
		100

SHËNIM: Aplikimet që marrin më pak se 50 pikë nuk do të konsiderohen të pranueshme

Kriteret e përzgjedhjes – Përpunimi i produkteve bujqësore në fermë dhe jashtë fermës

#	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1	Projekti kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike	15
2	Projekti krijon vende të reja pune dhe/ose ruan vendet ekzistuese të punës	15
3	Projekti promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore	15
4	Projekti synon të mbështesë prodhimin e produkteve me vlerë të shtuar, si edhe të produkteve tradicionale.	15
5	Projekti zbatohet në një zonë malore	10
6	Përpunimi i lëndëve të para bujqësore të prodhuara kryesisht në nivel lokal ose rajonal, brenda territorit të Kosovës.	10
7	Projekti forcon bashkëpunimin me fermerë të tjerë, biznese dhe aktorë lokalë për të nxitur zhvillimin socio-ekonomik të zonave rurale.	7
8	Aplikanti është fermer ose ndërmarrës i ri (nën 40 vjeç në momentin e aplikimit).	5
9	Aplikanti është grua	5
10	Aplikanti i përket një grupi minoritar	3
		100

SHËNIM: Aplikimet që marrin më pak se 50 pikë nuk do të konsiderohen të pranueshme

Kriteret e përzgjedhjes – Prodhimi i mjaltit

#	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1	Projekti kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike	15
2	Projekti krijon vende të reja pune dhe/ose ruan vendet ekzistuese të punës	15
3	Projekti promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore	15
4	Projekti synon përmirësimin e cilësisë së mjaltit dhe produkte të reja nga bletaria	15
5	Projekti zbatohet në një zonë malore	10
6	Projekti forcon bashkëpunimin ndërmjet prodhuesve të mjaltit dhe bizneseve lokale, me qëllim nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik në zonat rurale.	10
7	Projekti synon të rrisë numrin e koshereve të bletëve dhe të shtojë sasinë e prodhimit të mjaltit.	7
8	Aplikanti është fermer ose ndërmarrës i ri (nën 40 vjeç në momentin e aplikimit).	5
9	Aplikanti është grua	5
10	Aplikanti i përket një grupi minoritar	3
		100

SHËNIM: Aplikimet që marrin më pak se 50 pikë nuk do të konsiderohen të pranueshme

Kriteret e përzgjedhjes – Aktivitete jo-bujqësore

#	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1	Projekti kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike	15
2	Projekti krijon vende të reja pune dhe/ose ruan vendet ekzistuese të punës	15
3	Projekti promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore	15
4	Projekti synon të mbështesë artizanatin tradicional dhe zhvillimin e produkteve të reja.	10
5	Projekti synon shërbime inovative për sektorin ushqimor të bujqësisë rurale.	10
6	Projekti forcon bashkëpunimin me fermerë të tjerë, restorante dhe biznese të agroturizmit, me qëllim nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik të zonës rurale.	10
7	Projekti zbatohet në një zonë malore	10
8	Aplikanti është fermer ose ndërmarrës i ri (nën 40 vjeç në momentin e aplikimit).	7
9	Aplikanti është grua	5
10	Aplikanti i përket një grupi minoritar	3
		100

SHËNIM: Aplikimet që marrin më pak se 50 pikë nuk do të konsiderohen të pranueshme

Kriteret e përzgjedhjes – Rritja e shpendëve për prodhimin e vezëve dhe mishit

#	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1	Projekti kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike	15
2	Projekti krijon vende të reja pune dhe/ose ruan vendet ekzistuese të punës	15
3	Projekti promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore	15
4	Projekti fokusohet në përmirësimin e cilësisë së produkteve nga shpendët, përkatësisht vezëve dhe mishit, duke kontribuar në sigurinë ushqimore dhe rritjen e konkurrueshmërisë në treg.	15
5	Projekti forcon bashkëpunimin me fermerë të tjerë, restorante dhe biznese të agroturizmit, me qëllim nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik të zonës rurale	10
6	Projekti zbatohet në një zonë malore	10
7	Projekti synon të thellojë nivelin e përpunimit brenda zinxhirit të vlerës.	7
8	Aplikanti është fermer ose ndërmarrës i ri (nën 40 vjeç në momentin e aplikimit).	5
9	Aplikanti është grua	5
10	Aplikanti i përket një grupi minoritar	3
		100

SHËNIM: Aplikimet që marrin më pak se 50 pikë nuk do të konsiderohen të pranueshme

Kriteret e përzgjedhjes – Akuakultura

#	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1	Projekti kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike	15
2	Projekti krijon vende të reja pune dhe/ose ruan vendet ekzistuese të punës	15
3	Projekti promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore	15
4	Projekti synon të përmirësojë cilësinë e peshkut të freskët dhe produkteve të përpunuara të peshkut.	15
5	Projekti forcon bashkëpunimin me fermerë të tjerë të peshkut, biznese turistike dhe restorante lokale, si dhe me aktorë të tjerë lokalë, për të nxitur zhvillimin socio-ekonomik të zonës rurale.	10
6	Projekti zbatohet në një zonë malore	10
7	Projekti synon kultivimin e varieteteve të reja të peshkut.	7
8	Aplikanti është fermer ose ndërmarrës i ri (nën 40 vjeç në momentin e aplikimit).	5
9	Aplikanti është grua	5
10	Aplikanti i përket një grupi minoritar	3
		100

SHËNIM: Aplikimet që marrin më pak se 50 pikë nuk do të konsiderohen të pranueshme

JU FALEMINDERIT PËR VËMENDJE!

Për çdo pyetje apo paqartësi rreth procesit të aplikimit, ju lutem na kontaktoni në:

grantet@dd-bsc.com

+383 (0) 48 184 795

+383 (0) 49 184 795